- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës së defekteve dhe të cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të fillojë nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdojë vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjojë një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimi të përkohshëm.

Neni 35 Pranimi përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një **certifikatë të pranimi përfundimtar**, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimi do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimi nga Menaxheri i Projektit dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimi dhe të cilat kanë mbetur të parealizuar në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimi. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

Shkelja e kontratës dhe shkëputja

Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhën Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonës;

- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkelje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më parë që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 **“Force Madhore”** siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplodimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësi të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhësimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri I Projektit do të vërtetoj këtë. Kontraktuesi do të siguroj vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

PJESA III E KONTRATES

kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuhët në përdorim zyrtarë
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është 10 % e çmimit total të kontratës, nga një Bankë e licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës, apo kompani e sigurimeve e licensuar nga BQK deri me 20/12/2020
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Për humbje ose dëmtim të Punëve, Impianteve dhe Materialeve <i>[shëno shumat]</i> ; (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve <i>[shëno shumat]</i> ; (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën <i>[shëno shumat]</i> ; (d) dëmtim personal ose vdekje: (i) të punëtorëve të Kontraktuesit: <i>[shëno shumat]</i> (ii) të personave të tjerë: <i>[shëno shumat]</i>
Programi	12.1	Planin për Menaxhimin e Kontratës. Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda <u>2 ditëve</u> nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 2 ditë nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të projektit
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë : 2 (Dy) ditë pas nënshkrimit të kontratës, nëse kushtet atmosferike janë të përshtatshme (vlerësimi i Organit Mbikëqyrës të Autoritetit Kontraktues)
	17.2	Përfundimi i punëve bëhet sipas planit të menaxhimit të kontratës 20/11/2020
Dëmet e likuiduara	19.1	Norma e dëmeve të likuiduara është 0.10% e Çmimit final të Kontratës në ditë.

Regjistri i punës	20.1	
Inspektimi dhe testimi	22.1	Inspektimi i cilësisë dhe sasisë së punëve do të bëhet në momentin e dorëzimit që janë lëndë e kësaj kontrate, nga Komisioni I Pranimit të punëve – shërbimeve, i emëruar nga ana e Zyrtarit Kryesor Administrativ të Autoritetit Kontraktues. Asnjë furnizim i mallit respektivisht asnjë ekzekutim i punëve-shërbimeve nuk do të konsiderohet valid dhe i pranuar, deri sa nuk konfirmohet cilësia dhe sasia, nga ana e Komisionit të Pranimit të punëve-shërbimeve të Autoritetit Kontraktues. Menagjer I kontrates nga AK eshte: Behar Brenolli Menagjer I projektit nga AK eshte: Florim Krasniqi Menagjer I projektit nga OE eshte:Ekrem Tahiraj
Pagesa	24.2	Sipas Raportit të prezantuar – dorëzuar nga Menaxheri i Projektit- situacioneve të aprovuara nga ana e Organit mbikëqyrës- menaxherit të projektit deri në 70 % të projektit, pagesa do të kryhet në afate sa më të shkurtë kohor dhe jo më gjatë se 30 ditë nga data e pranimit dhe evidentimit të faturës.
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: nuk ka pagese paraprake
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: 10 % e vleres se kontrates per periudhen një vjeqare
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë [shëno numrin] ditë pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është : 12 muaj nga data e pranimit teknik të përkohshëm. Dokumenti Polisa e sigurimit të kualiteti e lëshuar nga një Bank apo kompani e sigurimeve e licensuar nga Banka Qendrore e Kosovës 10 % vleren e pergjithëshme të kontratës, me afat validiteti për prej 12 muaj nga data e pranimit teknik të përkohshëm
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve te likuiduara.
Zgjidhja miqësore e	42.2	Komisioni për Ndërmjetësim ne kuadër te Ministrisë së Drejtësisë

mosmarrëveshjeve		
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike, në pajtim me ligjin në Kosovë. b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë. Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

QKMF - 0 uqash
tinit project

Adaptimi i hapësirave të shërbimit emergjent në QKMF - Dragash
PARAMASA DHE PARALLOGARIA
faza: ARKITEKTURA

REKAPITULLIMI I PUNIMEVE TË PËRGJITHËSHME		
1	PUNËT PËRGATITORE	€ 1,081.50
2	PUNËT E DEMOLIMIT	€ 989.56
3	PUNËT TOKËSORE	€ 1,419.20
4	PUNËT E BETONIT	€ 8,065.75
5	PUNËT E ARMATURËS	€ 6,820.71
6	PUNËT E MURATIMIT DHE SUVATIMIT	€ 2,976.60
7	PUNËT E NGJYROSJES	€ 581.83
8	PUNËT E KULMIT NGA ÇELIKU	€ 5,087.33
9	PUNËT E LLAMARINËS	€ 2,079.60
10	PUNËT E NIVELIZIMIT DHE DYSHEMESË	€ 5,746.10
11	PUNËT E KERAMIKËS DHE GRANITIT	€ 2,773.20
12	PUNËT E FASADËS	€ 7,730.50
13	PUNËT E DYERVE DHE DRITAREVE	€ 3,090.00
14	PUNËT E TJERA	€ 9,393.60
15	PUNËT E RREGULLIMIT TË JASHTËM	€ 1,620.00
16	INSTALIMET ELEKTRIKE	€ 4,148.50
17	INSTALIMET HIDROTEKNIKE	€ 3,893.10
18	INSTALIMET MEKANIKE	€ 6,990.12
TOTAL:		€ 74,487.19

Adaptimi i hapësirave të shërbimit emergjent në QKMF - Dragash
PARAMASA DHE PARALLOGARIA
PUNËT PËRGATITORE

1.1	Punët përgatitore				
Pos	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Gjithsej
1.1.1	Inçizimi gjeodezik dhe shenjëzimi i lokacionit ekzistues sipas specifikimeve teknike, si dhe përcjellja e punimeve në vazhdimësi me instrumente gjeodezike deri sa të përfundojnë punimet në objektin i cili do të ndërtohet.	paushall	715	€ 0.10	€ 71.50
1.1.2.	Punëmatrësi është i detyruar që para fillimit të punimeve të bëjë rrethimin e punishtes me tabela prej llamarinës dhe me konstrukcion të përfuruar mirë në tokë. Lartësia e rrethojës duhet të jetë h=2 m. Në këtë pozicion të përfshihet edhe shënimi i kanticrit me shenja rreziku në zonat ku do të punohet gjatë kohës sa zgjasin punimet.	m'	70	€ 3.00	€ 210.00
1.1.3	Instalimi i objekteve të përkohshme (zyre mobile, toalete, depo). Montimi i tyre bëhet në bashkëpunim me organin mbikëqyres dhe investitorin.	paushall	1	€ 200.00	€ 200.00
1.1.4	Instalimi i përkohshëm i instalimeve komunale (uji, kanalizimi, mbeturinat, rryma me njëhësor nga rrjeti elektrik, gjeneratori).	paushall	1	€ 200.00	€ 200.00

1.1.5	Montimi i përkohshëm i tavolinës së armiruesve së bashku me mbulesën përkatëse (deri në 15 m gjatësi). Ë njëjta duhet të demontohet pas përfundimit të punimeve.	paushall	1	€ 200.00	€ 200.00
1.1.6	Ekzaminimi i materialeve para dhe pas vuarjes në vepër të tyre si psh. betonit, armatures dhe elementeve të tjera për shqyrtim si dhe prejardhjen e tyre. Kontraktori është i obliguar që të sjellë ateste paraprake dhe prejardhjen e materialit para fillimit të punimeve.	paushall	1	€ 200.00	€ 200.00
Pozicioni total 1.1:					€ 1,081.50

Pozicion total 1:	€ 1,081.50
-------------------	------------

Adaptimi i hapësirave të shërbimit emergjent në QKMF - Dragash
PARAMASA DHE PARALLOGARIA
PUNËT E DEMOLIMIT

2.1	Punët e demolimit				
Punëmarrësi është i detyruar që të gjitha materialet e demoluara (sipas pos. te poshtëshënuara) t'i largojë nga punishtja apo t'i transportojë deri në deponinë e caktuar për deponim materiale. Materialet që i nevojiten Qendrës së Mjekësisë Familjare (QMF) duhet të deponohen në depot e parapara për grumbullim të materialit në depot e QMF-së. Pra, materiali është pronë e investitorit.					
Pos	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Gjithsej
2.1.1	Identifikimi i instalimeve nëntokësore dhe mbitokësore (ujësjellësi, kanalizimi, instalimet e rrymës, instalimet e telefonisë dhe internetit, ngrohjes qendore dhe hidrantëve kundër zjarrit). Të bëhet piketimi dhe regjistrimi në ditarin ndërtimor me qëllim të parandalimit të dëmtimeve eventuale që mund të rezikojnë personelin. Në këtë pozicion parashihet edhe plani i situacionit të rrjetit ekzistues me qëllim që të hartohet plani i veprimt për shkyqje dhe demolim të rrjetit ekzistues, pastrimi i terrenit dhe përgatitja e kushteve teknike të përgjithshme për ndërtimin e punimeve të planifikuara në projektin	m2	240	€ 0.10	€ 24.00
2.1.2	Dislokimi i shtyllave të rrjetit elektrik të tensionit të ultë duke përfshirë telat, trupat ndriques, prizat, kabllo, etj. në shtyllat e reja nga druri apo betoni me lartësi deri në 9 m, rrjetin elektrik në pozicionin e ri të cilin e cakton menaxhmenti i QMF-së dhe organi mbikëqyrës. Të gjitha aktivitetet dhe shpenzimet e nevojshme për materialin përcjellës i bartë punëkryrësi.	copë	2	€ 50.00	€ 100.00
2.1.3	Demolimi me kujdes i kubëzave nga betoni, rigolave dhe anësorëve, si dhe deponimi i përkohshëm në një vend të sigurtë të caktuar nga organi mbikëqyrës. Të bëhet kujdes gjatë bartjes dhe transportit. Në çmim të llogaritët edhe transporti nga vendi i demolimit deri në vendin e deponimit.	m2	700	€ 0.50	€ 350.00
2.1.4	Demolimi me kujdes i strehës nga beton armeja mbi derën hyrëse dhe materialet përcjellëse si dhe demolimi i shkallëve ekzistuese. Të bëhet bartja e materialit të deponuar deri në deponinë e caktuar nga investitori. Të bëhet kujdes i shtuar në mbrojtjen e dyerve. Sasia llogaritët të jetë deri në 10 m2.	paushall	1	€ 50.00	€ 50.00
2.1.5	Demolimi me kujdes të shtuar të dyerve të garazhës dhe deponimi në një vend të sigurtë të caktuar nga investitori.	copë	3.00	€ 4.00	€ 12.00
2.1.6	Demolimi i murit ndarës d=12 cm i muratuar me tulla të plota, si dhe bartja e materialit të demoluar deri në deponinë e caktuar nga investitori.	m2	17.50	€ 2.00	€ 35.00

2.1.7	Demolimi me kujdes të shtuar i kanalit të betonit (kanal servisi) me gjatësi deri në 6 m. Materiali i demoluar të transportohet deri në deponinë e caktuar nga investitori.	paushall	1.00	€	20.00	€	20.00
2.1.8	Demolimi i dyshemesë së garazhave ekzistuese nga materialet e ndryshme dhe bartja e materialit të demoluar deri në deponinë e caktuar nga investitori.	m2	115.50	€	2.00	€	231.00
2.1.9	Demolimi me kujdes të shtuar i dritareve të ndryshme ekzistuese nga PVC. Dritaret e demoluara duhet të rivendosen në nivel -30 cm më poshtë se që kanë qenë më herët. Në çmim të llogaritë rimontimi i tyre dhe të gjitha pozicionet përcjellëse deri në finalizim (rregullimi i fasadës në vendet e dëmtuara, vendosja e sollbankave nga ana e brendshme dhe të jashtme etj.)	copë	10.00	€	2.00	€	20.00
2.1.10	Gërryerja e suvasë ekzistuese sipas nevojës nga murci dhe barja e materialit të gërryer deri në deponinë më të afërt.	m2	107.80	€	0.20	€	21.56
2.1.11	Demolimi i radiatorëve ekzistues të vendosur dhe mbyllja e përhershme e gypave për këta radiatorë.	copë	3.00	€	2.00	€	6.00
2.1.12	Demolimi me kujdes i hidrantit kundër zjarrit me kuti dhe mbyllja e përhershme e gypave për këtë hidrant.	copë	1.00	€	50.00	€	50.00
2.1.13	Demolimi i tabelave shpërndarëse të rrymës dhe çaktivizimi i tyre nga funksioni.	copë	2.00	€	5.00	€	10.00
2.1.14	Demolimi i lavamanëve me elemente përcjellëse dhe bojlerëve ekzistues.	copë	2.00	€	5.00	€	10.00
2.1.15	Demolimi i pushtave atmosferik dhe ujërave fekale të zeza në zonën e cila do të trajtohet. Në çmim të llogaritë edhe ofrimi i zgjidhjes alternative në mënyrë që të vazhdojë funksionimi i objektit ekzistues.	copë	5.00	€	10.00	€	50.00
Pozicioni total 2.1:							€ 989.56

Pozicion total 2:	€ 989.56
-------------------	----------

Adaptimi i hapësirave të shërbimit emergjent në QKMF - Dragash
PARAMASA DHE PARALLOGARIA
III PUNËT TOKËSORE

3.1	Punët e dheut, zhavorrit dhe rërës				
Pos	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Gjithsej
3.1.1	Gërryerja, gërmimi i dheut për rregullimin e themeleve shiritore të objektit të ri të ankesit, objektit ekzistues dhe pllatoz së re të kategorisë së dheut 3-5 me makina ndërtimore dhe me vegla dore. Materiali i tepërt i cili mbetet pas mbushjes deponohet dhe transportohet në deponinë e paraparë nga investitori. Llogaritja të bëhet me m3.				
	a - Gërmimi me makineri 60% të llogaritë me m3	m3	96	€ 3.00	€ 288.00
	b - Gërmimi me dorë 30%	m3	48	€ 3.00	€ 144.00
	c - Gërmimi me çekan 10%	m3	16	€ 20.00	€ 320.00
3.1.2	Planifikimi dhe punimi i bazamentit të objektit i cili do të trajtohet: themelet, dyshemet ekzistuese, dyshemet e reja, etj.	m2	280	€ 0.50	€ 140.00
3.1.3	Furnizimi i materialit, shtrirja, ngjeshja e tamponit me fraksion 0-63 mm në bazën e themeleve shiritore me trashësi t=15 cm, me ngjeshmëri përkatëse.	m3	20.40	€ 8.00	€ 163.20
3.1.4	Furnizimi i materialit, shtrirja, ngjeshja e tamponit me fraksion 0-63 mm në bazën e dyshemesë me trashësi t=15 cm, me ngjeshmëri përkatëse.	m3	30.00	€ 8.00	€ 240.00
3.1.5	Furnizimi i materialit dhe mbushja mbrapa murit me zhavorr të pastër të lumit me fraksion 63 mm në tërë gjatësinë e murit të lartësi deri në 50 cm.	m3	9.60	€ 8.00	€ 76.80
3.1.6	Furnizimi i materialit dhe montimi i gypit drenazhues PVC fi 110. Në çmim të parashihet edhe punimi i shtresës stabilizuese nga betoni sipas skemës në projekt si dhe mbulimi me shtresë gjeotekstil.	m'	20.00	€ 2.00	€ 40.00

3.1.7	Furnizimi i materialit dhe mbushja brenda kthinave të mureve të themelit me dhunë e gërmuar në shtresa deri në 20 cm me ngjeshje.	m3	36.00	€ 0.20	€ 7.20
Pozicioni total 3.1:					€ 1,419.20

Pozicioni total 3:	€ 1,419.20
--------------------	------------

Adaptimi i hapësirave të shërbimit emergjent në QKMF - Dragash
PARAMASA DHE PARALLOGARIA
PUNËT E BETONIT

4.1	Punët e betonit				
Pos	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Gjithsej
Të gjitha pozicionet e strukturave të betonit dihet të realizohen sipas dimensioneve, llojit dhe klasës së betonit sipas dokumentacionit teknik të projektimit, llogaritjes statike dhe detajeve të armimit. Betoni për të gjitha llojet e punimeve duhet të përgatitet, transportohet, punohet, mirëmbahet dhe testohet sipas parashikimeve të përcaktuara në rregullat për standardet teknike për beton dhe beton armë. Të gjitha kallupet të pjesëve të dukshme të betonit duhet të lyhen dhe të jenë të kualitetit të lartë në mënyrë që të përmbushin kriteret e larta vizuale, estetike të sipërfaqeve të betonuara. Betoni për betonimin e mureve dhe shtyllave të jashtme prapa të cilave bëhet mbushja me argjinatur, duhet të iu shtohet hidroizolimi vertikal dhe shtimi i aditiveve të papërshkueshmërisë së ujit. Çmimi në njësi i secilit pozicion të këtyre punimeve përfshinë gjithësa që është e nevojshme për finalizimin e të njëjtit pozicion.					
4.1.1	Furnizimi transporti dhe punimi i shtresës rralfshuese për betonimin e themeleve shiritore nga betoni i thjeshtë C12/15 me trashësi 5cm. Në çmim të llogaritjet mirëmbajtja e betonit, dhe punimet sipas detaleve të dhëna në punimin grafik.	m³	2.45	€ 65.00	€ 159.25
4.1.2	Furnizimi transporti dhe betonimi i themeleve shiritore me dimensione sipas llogaritjes statike deri në nivelin e sipërme të pllakes së perdhese. Punimi të bëhet nga betoni i armuar i klasës C25/30. Në llogari të merret edhe pahija e nevojshme.	m³	48.30	€ 70.00	€ 3,381.00
4.1.3	Furnizimi transporti dhe betonimi i pllakes së dyshemesë/perdhese së objektit ekzistues me trashësi 15cm. Punimi të bëhet nga betoni i armuar me armaturë rrjetë dhe me tra të fshehtë sipas planit të armimit dhe llogaritjes statike. Klasa e betonit është C25/30 dhe duhet të përmbajë aditiv në jo ujëperkueshmeri. Në llogari të merret edhe pahija e nevojshme. Të merret mostra dhe përveq testimit në shtypje të bëhet edhe testimi në ujëperkueshmeri.	m³	17.25	€ 70.00	€ 1,207.50
4.1.4	Furnizimi transporti dhe betonimi i pllakes së dyshemesë/perdhese së aneksit të ri me trashësi 20 cm. Punimi të bëhet nga betoni i armuar me armaturë rrjetë dhe me tra të fshehtë sipas planit të armimit dhe llogaritjes statike. Klasa e betonit është C25/30 dhe duhet të përmbajë aditiv në jo ujëperkueshmeri. Në llogari të merret edhe pahija e nevojshme. Të merret mostra dhe përveq testimit në shtypje të bëhet edhe testimi në ujëperkueshmeri. Në çmim të llogaritjet edhe fuga dilatuese.	m³	18.50	€ 70.00	€ 1,295.00
4.1.5	Furnizimi, transporti dhe betonimi i shtyllave të veçuara drejtkëndore të dimensioneve të ndryshme nga betoni i armuar C25/30 i cili duhet të përmbajë aditiv në jo ujëperkueshmeri. Dimensionet e shtyllave të punohen sipas projektit. Në llogari të merret edhe pahija e nevojshme.	m³	3.57	€ 70.00	€ 249.90

4.1.6	Furnizimi, transporti dhe betonimi i shtyllave të veçuara rrethore nga betoni i armuar C25/30 i cili duhet të përmbajë aditiv ne jo ujepërkueshmeri. Dimenzionet e shtyllave të punohen sipas projektit. Në llogari të merret edhe pahia e nevojshme.	m³	1.20	€ 70.00	€ 84.00
4.1.7	Furnizimi transporti dhe betonimi i trareve në pllaken e perdhese nga betoni i armuar C25/30 me dimenzione të ndryshme. Dimenzionet e punohen sipas projektit të dhene në llogaritjen statike. Në llogari të merren edhe pahite e nevojshme.	m³	10.65	€ 70.00	€ 745.50
4.1.8	Furnizimi transporti dhe betonimi i pllakes mbi perdhese me trashesi d=20cm. Punimi të behet nga betonit i armuar me armaturë rrjetë dhe me tra të fshehtë sipas planit të armimit dhe llogaritjes statike. Klasa e betonit është C25/30 dhe duhet të përmbajë aditiv ne jo ujepërkueshmeri. Në llogari të merret edhe pahija e nevojshme. Të merret mostra dhe perveq testimit në shtypje të behet edhe testimi në ujepërkueshmeri. Në çmim të llogaritet edhe fuga dilatarese.	m²	13.48	€ 70.00	€ 943.60
Pozicioni total 4.1:					€ 8,065.75

Pozicioni total 4:	€ 8,065.75
--------------------	------------

Adaptimi i hapësirave të shërbimit emergjent në QKMF - Dragash
PARAMASA DHE PARALLOGARIA
PUNËT E ARMATURËS

5.1	Punët e armaturës				
Pos	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Gjithsej
Të gjitha llojet e armaturave duhet të pastrohen nga dryshku, balta dhe gëlqerja, prerja, lakimi dhe vendosja e saktë sipas llogaritjeve statike dhe detaleve të armaturës. Para betonimit, organi mbikëqyrës duhet të kontrollojë vendosjen e saktë të armaturës. Lloji i armaturave sipas detaleve në projekt: armatura B 500 C dhe armatura MA-Q (armaturë rrjetë).					
5.1.1	Furnizimi i hekurit ndërtimor, pastrimi, prerja, përpunimi dhe montimi i armaturës së brinjëzuar të klasës së cekur, të gjitha në përputhje me llogaritjen statike sipas detaleve teknike të përfshira në planin e armimit në projekt.				
	a - armatura RA I	kg	7574.26	€ 0.65	€ 4,923.27
	b - armatura rrjetë Q-238 dhe Q-335	kg	2919.14	€ 0.65	€ 1,897.44
Pozicioni total 5.1:					€ 6,820.71

Pozicioni total 5:	€ 6,820.71
--------------------	------------

Adaptimi i hapësirave të shërbimit emergjent në QKMF - Dragash
PARAMASA DHE PARALLOGARIA
PUNËT E MURATIMIT DHE SUVATIMIT

6.1	PUNËT E MURATIMIT dhe SUVATIMIT				
Pos	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Gjithsej
6.1.1	Furnizimi, transportimi dhe muratimi i mureve të brendshme me blloqe siporex me dimenzione 60x25x20 cm me ngjitës dhe me të gjitha punët paraprake. Llogaritja të behet për m2 të murit të punuar.	m²	43.17	€ 20.00	€ 863.40

6.1.2	Furnizimi, transportimi dhe muratimi i mureve të brendshme me blloqe siporeks 60x25x12.5 cm me ngjites perkates dhe me të gjitha punët paraprake. Llogaritja te behet per m2 te murit te punuar.	m ²	54.60	€ 12.00	€ 655.20
6.1.3	Suvatimi i mureve të brendëshme ne kthina, korridore, nyje sanitare deri ne kuoten e leshuar te pllafonit "Amstrong" me llaq të çimentos dhe gelqeres në shtrese me trashesi prej t=2.5 cm dhe shtrese paraprake qumshiti te çimentos. Ne cmm duhet te llogariten edhe kendet metalike te pjesa e dycrve, dritareve dhe ne te gjitha kendet e tjera te nevojshme.	m ²	324.00	€ 4.50	€ 1,458.00
Pozicioni total 6.1:					€ 2,976.60

Pozicioni total 6:	€ 2,976.60
--------------------	------------

Adaptimi i hapësirave të shërbimit emergjent në QKMF - Dragash
PARAMASA DHE PARALLOGARIA
PUNËT E NGJYROSJES

7.1	Punët e ngjyrosjes				
Pos	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Gjithsej
7.1.1	Furnizimi me material dhe patinimi (gjetimi) i mureve ne dy shtresa deri në pregaditjen e siperfaqes per pranimin e ngjyres.	m ²	216.17	€ 1.50	€ 324.26
7.1.2	Furnizimi i materialit dhe ngjyrosja e mureve të korridorit me ngjyrë ne tri shtresa. Deri ne lartesine h=1.2m, te aplikohet ngjyra e yndyrshme e cila mund te mirembahet-pastrohet me uje. Ngjyren e cakton organi mbikqyres.	m ²	20.65	€ 3.00	€ 61.95
7.1.3	Furnizimi, transportimi dhe ngjyrosja e mureve të kthinave të brendshme me ngjyrë dispersive. Ngjyren e cakton organi mbikqyres.	m ²	195.62	€ 1.00	€ 195.62
Pozicioni total 7.1:					€ 581.83

Pozicioni total 7:	€ 581.83
--------------------	----------

Adaptimi i hapësirave të shërbimit emergjent në QKMF - Dragash
PARAMASA DHE PARALLOGARIA
PUNËT E KULMIT NGA ÇELIKU

8.1	PUNËT E KULMIT				
Pos	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Gjithsej
Kushtet e përgjithshme për punimin e konstrukcionit metalik: Kryesi i punimeve përveç përshkrimit të asortimenteve individuale të punimeve, duhet të përfshijë në çmime kushtet e mëposhtme të zakonshme: punimet e bravarisë punuese do të realizohen në përputhje me projektin, skemat dhe detalet, dhe standardet e zbatueshme që përshkruajnë normat dhe standardet e punës në ndërtim.					

[Signature]

8.1.1	Furnizimi, transporti, prodhimi dhe montimi i strukturave metalike, nënkonstrukcioneve të gjitha nga profilet dhe kutitjat metalike me cilësi standarde me të gjithë materialin e nevojshëm përcjellës lidhës. Sipërfaqet e profileve dhe kutijave metalike para ngjyrosjes paraprakisht përgatiten në përputhje me rregulloret mbi masat teknike dhe kushtet për mbrojtjen e konstrukcionit të çelikut nga korezioni. Konstrukcioni metalik minimizohet me ngjyre bazë në dy shtresa, si dhe me dy lyreje me ngjyrë metalike yndyrore.	kg	3633.81	€	1.40	€	5,087.33
Pozicioni total 8.1:							€ 5,087.33

Pozicioni total 8:	€	5,087.33
--------------------	---	----------

Adaptimi i hapësirave të shërbimit emergjent në QKMF - Dragash
PARAMASA DHE PARALLOGARIA
PUNËT E LLAMARINËS

9.1	PUNËT E MBULIMIT				
Pos	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Gjithsej
Përveç përshkrimit të artikujve individualë të punimeve, kontraktori përfshinë në çmime kushtet e mëposhtme të zakonshme: Punimet me llamarinë metalike do të bëhen në gjithëcka sipas projektit, detajet dhe standardet e vlefshme. Mimet përfshijnë të gjitha operacionet e punës dhe konsumin e materialit, si dhe mjetet ndihmëse dhe skelat që përkrahajnë "Normat dhe standardet e punës në ndërtim".					
9.1.1	Furnizimi me material i llamarines per mbulimin e kulmit me llamarine te galvanizuar me trashesi TR 0.60mm dhe brinjë 60/210, në ngjyrën e erret. Në çmim përfshihet i gjithë materiali i nevojshëm lidhës, skelat dhe pajisjet për montim dhe instalim. Mbulimi sipas projektit, detajet dhe udhëzimet e prodhuesit dhe projektuesit.	m2	157.50	€ 8.00	€ 1,260.00
9.1.2	Furnizimi me material i llamarines per punimin e kallkaneve skajore te kulmit me llamarine te galvanizuar me trashesi 0.60 mm, në ngjyrën e erret. Në çmim përfshihet i gjithë materiali i nevojshëm lidhës, skelat dhe pajisjet për montim dhe instalim.	m2	17.50	€ 8.00	€ 140.00
9.1.3	Furnizimi me material, punimi dhe montimi i të gjitha investimeve te murve te fasades ekzistuese dhe skajoreve te kulmit me fasadën ekzistuese me llamarine te galvanizuar me trashesi TR = 0.60 mm me ngjyre te erret. Në çmim përfshihet i gjithë materiali i nevojshëm lidhës, skelat dhe pajisjet për montim dhe instalim.	m'	18.10	€ 8.00	€ 144.80
9.1.4	Furnizimi me material, punimi dhe montimi i një ulluqe horizontal nga llamarina e galvanizuar d = 0.60 mm me një gjerësi të zhvilluar deri 1.1 m. Në çmim përfshihet i gjithë materiali i nevojshëm lidhës, skelat dhe pajisjet për montim dhe instalim.	m'	27.20	€ 9.00	€ 244.80
9.1.5	Furnizimi me material, punimi dhe montimi i ulluqeve vertikale nga llamarina e galvanizuar me dimensione katrore 14x14cm. Në çmim përfshihen te gjitha elementet e nevojshme per realizimin e ketij pozicioni.	m'	10.00	€ 9.00	€ 90.00

Handwritten signature/initials

